

Dr. Musli Vërbani

Gjoksi i pulës i Naim Tërnavës

Kaçanik, 2019

Autori:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Gjoksi i pulës i Naim Tërnavës

Botues:
Autori

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Hyrje

Lufta kishte përfunduar, forcat e NATO-s ishin vendosur në Kosovë, UNMIK-u kishte filluar punën e vet në Kosovë, pas largimit të forcave Serbe nga Kosova ishin mbajtur zgjedhjet qendrore në Kosovë.

Kosova kishte nevojë për ndryshime në të gjitha aspektet, Naim Tërnavë kishte marrë iniciativën (*Kryetar i Kuvendit të BIK*) për ndryshimin e kushtetutës së BIK-ut. Ndoshta dikush do të mendonte se ky ndryshim bëhej ngase kishin ndryshuar kushtet dhe rrethanat, por e vërteta ishte krejt ndryshe, nuk ishte qëllimi i ndryshimit të Kushtetutës së BIK-ut në bazë të kushteve dhe rrethanave të krijuara, por qëllimi ishte që Naim Tërnavë të merrte timonin e BIK-ut, por jo që të merrte timonin për ta orientuar në drejtim të duhur por për ta stagnuar, për ta izoluar dhe për ta bllokuar islamin institucional në Kosovë (*siç do ta tregojmë në vazhdim*).

Përpos disa ndryshimeve *Kozmetike* në të ashtuquajturën *Kushtetutë e BIK-ut*, nuk u ndryshua asgjë, vetëm se u ndryshua kushtetuta e BIK-ut me nënshkrimin e Naim Tërnavës (*si Kryetar i Kuvendit*), që kryetari i BIK-ut të mos ketë të drejtë të kandidojë më shumë se dy herë (*dy mandate me nga 4 vite*).

Rexhep Boja, i cili deri atëherë ishte kryetar i BIK-ut, e pranoi ndryshimin e këtij neni, kushtetuta ndryshoi dhe Naim Tërnavë u zgjodh kryetar i BIK-ut.

Po, Naim Tërnavë u zgjodh i pari i BIK-ut dhe pasi që e mori pozitën e rihte gjoksin: **“Unë përfaqësoj 2 milion qytetarë musliman të Kosovës”**. E, a i përfaqësoi Naim Tërnavë 2 milion musliman, e vërteta e tregon të kundërtën.

Vitet kalonin dhe përafërsisht kaluan dy dekada (8 vite) dhe 2 milion musliman prisnin prej të parit të tyre se do t'i përfaqësonte ata.

Gjoksi prej pule i Naim Tërnavës nuk përfaqësonte 2 milion siç pretendonte ai vazhdimisht, por ishte një gjoks pule dhe përfaqësonte vetëm punëtorët e tij dhe veten e tij.

Çështjen e parë dhe kryesore të cilin asnjëherë nuk mundi ta rregullonte, ishte rregullimi i statutit juridik institucional të BIK-ut.

U rregulluan shumë institucione, e në mesin e atyre institucioneve u rregullua edhe gjendja e kafshëve duke përfshi edhe qentë endacak (*të cilët kafshonin fëmijët nëpër rrugë*) dhe ata qen endacak ishin të mbrojtur me ligj sepse ishte dikush i cili i mbronte, ndërsa ata të cilët i përfaqësonte Tërnavë, nuk ishin të mbrojtur edhe pse ato të drejta ishin prej të drejtave themelore dhe të lirive të njeriut. Gjoksi i pulës i Naim Tërnavës i cili pretendonte se i përfaqëson 2 milion nuk ishte në gjendje t'i mbronte vajzat e mbuluara të cilat përjashtoheshin nga shkolla vetëm se ishin me mbulesë, pra ata përjashtoheshin nga shkolla vetëm sepse kishin mbulesë.

Në shtetin fqinj të Maqedonisë u fut lënda fetare, po ashtu edhe në Preshevë, ndërsa gjoksi i (pulës) Naim Tërnavës, i cili pretendonte se i përfaqëson dy milion nuk ishte në gjendje të fuste lëndën e edukatës fetare nëpër

shkolla. Ai edhe më tutje e rrihte gjoksin se i përfaqëson 2 milion qytetarë.

Në Shqipëri, edhe pse gjatë sistemit komunist ishin mbyllur edhe xhamitë e mos të flasim se a ka pas medrese, u hap “Universiteti Islam Bedr”, ndërsa Tërnavë mbeti vetëm me një fakultet i cili ishte i themeluar që nga masat e dhunshme, pra me “Fakultetin (e përgjithshëm) e Studimeve Islame”.

“Xhamia e namazgjasë” në Tiranë dhe “Xhamia qendrore në Prishtinë”, që të dyja e kishin siguruar fondin e ndërtimit, por ajo e Tiranës është në përfundim e sipër dhe sivjet (2019) do të bëhet hapja solemne e saj, a nga ana tjetër, për çdo vit brenda një dekade të tërë, Naim Tërnavë edhe pse e kishte projektin prapëseprapë nuk ia arriti deri më sot ta realizonte (2019) sepse *gjoksi i tij i pulës* nuk mund t’i përfaqësonte 2 milion muslimanë.

Naim Tërnavë me gjoksin e tij të pulës të cilën e rreh vazhdimisht nuk mund të mbronte as njërën prej xhamive më të vjetra në kryeqytet, pra restaurimin e “Xhamisë së Çarshisë” në qendër të Prishtinës e cila ka mbetur në gjysmë. Ajo xhami filloi të restaurohej por ngeci. Ka kaluar një dekadë dhe në atë xhami edhe sot e kësaj dite hedhen mbeturina, urinohet në të, zhvillohet prostitucioni dhe përdoret droga dhe ai arsyetohet se këtë çështje e kanë në dorë të tjerët dhe se po ta kishte në dorë ai do ta restauronte me kohë. A thua ku i mbeti gjoksi i tij i pulës i cili pretendonte se i përfaqëson 2 milion sepse xhaminë po ia përfaqësuaka dikush tjetër?

Naim Tërnavë i cili e kishte ndryshuar kushtetutën për t’u zgjedhur i pari i BIK-ut, pas tetë viteve e ndryshoi

përsëri për të pasur të drejtë të rikandidohej dhe të zgjidhet më shumë se dy mandate dhe atë me nga 5 vite, dhe për të parën herë ai e ndryshoi nenin kushtetues për të mos pasur të drejtë ish Kryetari i BIK-ut të kandidohej më shumë se dy herë nga 4 vite tani për të dytën herë e ndryshoi vet për të pasur të drejtë që vet të rikandidohej dhe të rizgjidhet edhe më shumë se dy mandate dhe atë me më shumë se dy herë nga 5 vite.

Padyshim se gjoksi i tij kësaj radhe funksionoi sepse vet e kishte nënshkruar ndryshimin për të parën herë dhe prapë tani me nënshkrimin e tij e fshiu dhe e ndryshoi me dorën e tij, dhe këtë ndryshim e bëri sikurse pula e cila me këmbën e saj i fshin gjurmët e saj.

Në fund, Naim Tërnavën mund ta përshkruajmë me atë se ai ndryshoi fytyrën e tij prej njeriu me mjekër të rruar dhe me mustaqe të zgjatura në njeri me mustaqe të shkurtuara dhe me mjekër të lëshuar. Edhe pse u ndryshua vet me shkurtim të mustaqeve, nuk vërehet se ka ndryshuar në lëshimin e mjekrës sepse edhe nëse e ka lëshuar mjekrën për ca milimetra as që vërehet se është lëshim i mjekrës ashtu siç nuk vërehet ndonjë ndryshim në atë që përfaqëson “dy milionët” e tij.

Naim Tërnava u kujdes vetëm për ta ruajtur postin e tij

14.08.2014

Më datën 08.03.2012, Sabri Bajgora në lajmet e RTK-së ka deklaruar se: “Imam Musli Vërbani, Imam në xhaminë e Kaçanikut, është i rrezikshëm për xhematin e vet.”, ndërsa nuk e tregonte realitetin, se unë kam qenë i rrezikshëm për rrymën Vehabite, saktësisht “i rrezikshëm” për Lavdrim Muhaxherin dhe Jeton Rakën (i cili e ka djegur automjetin tim) të cilët luftojnë në Siri dhe të cilët kanë pasur ide Vehabiste, po ashtu edhe ndaj Ilir Berishës edhe Jetmir Kyqyikut të cilët janë në mesin e të arrestuarve nga Kaçaniku.

Më 12.06.2013 Naim Tërnava në Interaktiv me zë të fuqishëm thoshte: “Mos e traumatizoni këtë popull me terma të Vehabizmit dhe të radikalizmit!?”.

Ndërsa dje me datën 13.08.2014 në zërin e Amerikës Naim Tërnava deklaroi se: “gjithmonë ka qenë i shqetësuar për aktivitetet e tilla”. Është e vërtetë se Naim Tërnava ka qenë i shqetësuar, ama për postin dhe karrigen e tij, e në 5 vitet e fundit veçoi gjithçka vetëm e vetëm që ta ndryshoj kushtetutën dhe të bëhet Mufti i përjetshëm të cilën e arriti me dhunë dhe me përjashtime të pamëshirshme.

Sido që të jetë duhet ditur se: Deklaratat e krerëve të BIK-ut janë vetëm një ambalazh për të fshehur “të ligat” e tyre dhe asgjë tjetër.

A punon BIK-u “në të zezë”

Më 15 janar 2015, në emisionin Target të RTK-së, avokati i popullit Sami Kurteshi në mes tjerash tha se: *“BIK nuk është e regjistruar në institucionet shtetërore dhe kjo nënkupton se në çdo moment mund të kontrollohet dhe t’i konfiskohet e tërë pasuria”*. Kjo thënie më shtyri të shkruaj jo vetëm për atë çka deklaroi avokati i popullit, por edhe për atë se BIK-u dhe punëtorët e BIK-ut a punojnë “në të zezë” apo jo?.

Pa dashur të hyjë më thellë në deklaratën e tij se sa është serioze dhe sa joserioze, a do të zbatohet apo nuk do të zbatohet, e ndjej për obligim të them që deklarata e tij ka qenë si një sinjal se BIK-u sa më parë duhet të i merr hapat e domosdoshëm që të regjistrohet në organet shtetërore.

Në popull thuhet se: “faji është jetim”. Kush është fajtor në këtë rast? Shteti apo BIK-u? Kushdo që të jetë fajtor, në këtë rast përgjegjësinë kryesore e ka BIK-u sepse nuk i ka marrë hapat dhe nuk po i merr hapat të cilat i takojnë por ka qëndruar duarkryq.

Krerët e BIK-ut i mashtrojnë punëtorët e tyre se e kanë “kushtetutën” e tyre. A janë punëtorët e BIK-ut që punojnë “në të zezë”, ndoshta shumëkush nuk do ta besonte, bile as që do ta imagjinonte, por e vërteta është se krerët e BIK-ut mashtrojnë punëtorët e tyre duke u thënë atyre se janë duke punuar si punëtorë me të drejta të barabarta me punëtorët tjerë të organizatave publike shtetërore e që në realitet është e kundërta sepse punëtorët në BIK në kuptim

klasik punojnë “në të zezë” ashtu siç punojnë “në të zezë” punëtorët në përndim e gjetiu.

BIK-u brenda 15 viteve i ka mbledhur nga punëtorët e vet shtesën e trustit të pensionit, mirëpo gjatë 15 viteve ato mjete nuk i ka derdhur në fondin e trustit të pensionit. Dihet se pagesa e trustit të pensionit bëhet edhe nga organizatat publike dhe jo publike por edhe nga firmat private, ndërsa po del në shesh se BIK-u nuk është as firmë private dhe as organizatë publike. Mjetet e trustit të pensionit të cilat i ka mbledhur BIK-u nga punëtorët e tij nuk i ka derdhur në fondin e trustit të pensionit dhe kjo dëshmon se punëtorët e BIK-ut faktikisht kanë punuar “në të zezë” dhe vazhdojnë të punojnë “në të zezë”.

Për krerët e BIK-ut kjo është një çështje “e thjeshtë” sepse faktikisht atyre u ka konvnuar kjo gjendje dhe vazhdon të iu konvenoj sepse moskontrollimi i tyre nga askush u lë hapësirë atyre që të pasurohen, përderisa fajtor e bëjnë shtetin.

Sa do të zgjas kjo gjendje? Si dhe kur do të rregullohet statuti i Bashkësive fetare, për krerët e BIK-ut nuk është me rëndësi, është me rëndësi që ata të deklarojnë në media se kanë kushtetutë ndërsa sa u vlen ajo kushtetutë nuk është me rëndësi.

Ligjërimi për veten dhe pozitën

Më datën 24/11/2015, Naim Tërnavë promovoi librin **“Ligjërime për fe dhe atdhe”**. Libri në fjalë do të duhej të ishte **“Ligjërime për të shfrytëzuar fenë dhe atdheun për përfitime vetanake”** (sepse edhe vet botimi i librit është bërë nga mjetet e fesë dhe atdheut e mos të flasim për çështjet tjera), transmeton Gazeta NewBorn.

Autori në fjalë, po të ishte ndonjë ushtar i UÇK-së, apo ndonjë atdhetar dhe luftëtar si Mulla Idriz Gjilani kjo do të ishte në rregull, por libri në fjalë tregon për hipokrizinë e autorit, i cili ligjërimet i ka në kundërshtim me veprat e tij. Për të argumentuar këtë i referohemi faktit se gjatë luftës së UÇK-së kur atdheu ishte në flakë, digjeshin dhe shkatërroheshin xhami e shtëpi, vriteshin imamë, kur masakroheshin gra, fëmijë dhe pleq, ai gjente kohë të bredhte në rrugët e Maqedonisë dhe të krenohesh se si ka kontribuar për fenë dhe atdheun. Kur atdheu thërriste që ai të ishte në ballë të UÇK-së ai kishte gjetur rrugën që të ishte në ballë të refugjatëve sepse kishte “ligjëruar për fenë dhe atdheun”!.

Pasi përfundoi lufta, kur mijëra shtëpi të djegura dhe të shkatërruara kërkonin ndërtim dhe rindërtim, kur mijëra të zhdukur kërkoheshin nga familjarët e tyre, kur mijëra jetimë kërkonin mbështetje dhe ledhatim, kur populli ballafaqohej me uri dhe varfëri ai zgjodhi rrugën e të jetuarit jetë luksoze, rrugën e shtimit të pasurisë në emër të fesë dhe atdheut sepse nuk i kishte mjaftuar ajo që e kishte fituar para lufte në emër të tyre dhe atë prapë nëpërmjet ligjëratave “për fe dhe atdhe”!.

Kur feja dhe atdheu rrezikohej nga rryma vehabiste, autori ngrihej vazhdimisht në pozitë edhe më të lartë dhe nuk kishte kohë të shihte se çfarë po ndodh poshtë sepse nevojitej të pasurohej edhe më shumë dhe të jetoj jetë luksoze.

Xhamitë e shkatërruara edhe pas 16 viteve ende presin të rindërtohen edhe pse xhemati falet në dhe (balte) nuk ka rëndësi sepse me rëndësi është që ai të shtroj shtëpinë e tij me shtroja të mbretërve.

Në fund, “ligjëratat për fe dhe atdhe” e mësuan që të ndryshoj kushtetutën e institucionit të tij të cilin e kishte nënshkruar me dorën e tij për të mbetur i “përgjithmonshëm në fronin e tij” dhe të kuptohej hipokrizia e tij dhe lakmia e tij për pozitë.

BIK-u dje dhe sot

Ishin Yjet ndriçues, dijetarët, ku u printe ef. Hasan Nahi, ef. Sherif Ahmeti, ef. Sadri Prestreshi. Vitet kur vepruan këta, ishte kulminacioni i komunizmit në ish-Jugosllavi në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti. Mirëpo këta dijetarë Islam në atë kohë nuk e shfrytëzonin pozitën për përfitime personale por për përfitim të islamit, ata e dëmtonin veten për dobi të përgjithshme. Këta yje ndriçues që ishin në krye të institucionit islam kishin themeluar medresenë në të cilën mësonin nxënës që nga Mali i zi, Maqedoni, Preshevë, sepse nuk kishte Medrese në këto troje. Në “Medresenë Alauddin” të Prishtinës mësonin edhe nga sanxhaku dhe Bosnja. Përpos themelimit të Medresesë u ndërtua objekti i Medresesë i cili objekt është objekt madhështor edhe i shekujve në vijim e mos të flasim për të sotmen.

Por parashtrohet pyetja, çka ndodhi me Bashkësinë Islame kur në krye të saj erdhi Naim Tërnavë me krerët e saj të sotëm?

Nëse e bëjmë një krahasim me Bashkësitë Islame shqiptare të kësaj kohe në rajon shohim se pothuajse janë barazuar me BIK-un i cili ka mbet në gjendjen ZERO bile për disa çështje edhe nën ZERO. Kjo nga shkaku se sot krerët e BIK-ut e shfrytëzojnë pozitën për përfitime personale.

Për të argumentuar këtë mund të themi se sot Presheva ka medresenë, në bashkësitë fetare (duke mos llogaritur bashkësinë islame të sanxhakut) mësohet lënda fetare islame ne shkolla publike, Mali i zi ka medresenë BFI, në

Maqedoni ka medrese në Kondovë, Tetovë dhe Gostivar, Fakultetin e shkencave Islame, Imamët e kanë të rregulluar sigurimin shëndetësor dhe pensional dhe mësohet lënda fetare në shkolla publike.

Në Kosovë, BIK-u e cila krenohet me sukseset e saja ende nuk e ka të rregulluar statusin fetar, imamët nuk e kanë të rregulluar sigurimin shëndetësor dhe pensional, FSI nuk është e akredituar, lënda fetare nuk mësohet në shkolla publike, parcela e ndarë për ndërtimin e xhamisë qendrore në Prishtinë ka mbetur vetëm parcelë.

Në anën tjetër, në dy festat fetare (Bajramet) Qeveritare shumë funksionarë shkojnë në seli të BIK-ut dhe ua urojnë krerëve të BIK-ut festën e bajramit. Në shikim mediatik të bën të kuptosh se raportet ndërmjet tyre janë në nivele të shkëlqyeshme, por realiteti e tregon të kundërtën sepse kjo është vetëm një reklamë mediatike dhe asgjë tjetër. Nga selia e BIK-ut duke buzëqeshur krerët e BIK-ut e dërgojnë mesazhin para kamerave dhe falënderojnë qeveritarët për përvetësimin e festave dhe lavdërohen për atë që nuk e kanë bërë, u deklarojnë qytetarëve që të mos brengosen për mosrregullimin e statusit të fesë islame, të mos brengosen se nuk ndërtohet xhamia e madhe në Prishtinë se falja në baltë është më e vlefshme, të mos brengosen se nuk bëhet akreditimi i FSI-së, të mos brengosen imamët pse ende nuk e kanë të rregulluar sigurimin shëndetësor dhe pensional, të mos brengosen pse nuk mësohet lënda fetare në shkolla publike.

T'i kthehemi shtetit amë, Shqipërisë, e cila deri në vitin 1990 i kishte të mbyllura xhamitë dhe medresetë por sot Komuniteti Musliman i Shqipërisë ka medresetë në Tiranë, Kavajë, Shkodër, Korçë. Komuniteti Musliman i Shqipërisë ka hapur edhe universitetin Islam (universitetin Bedr), si dhe ndërtimi i xhamisë së madhe në Tiranë është në ndërtim e sipër.

Ne vazhdimisht i dëgjojmë deklaratat e krerëve të BIK-ut duke u lavdëruar për atë që nuk e kanë bërë dhe duke deklaruar se janë më të suksesshmit, ndërsa e vërteta të cilën e treguam më lartë tregon se ata janë më të humburit dhe më të dështuarit në krahasim me institucionet simotra në vendet në rajon. Ndoshta pos medresesë së Prishtinës të cilën e kanë themeluar Yjet ndriçues, ef. Hasan Nahi, ef. Sherif Ahmeti dhe ef. Sadri Prestreshi, krerët e BIK-ut kanë hapur medresetë në Prizren dhe Gjilan me paralelet e djemve dhe të vajzave, kanë hapur edhe FSI-në e cila edhe pas më shumë se dy shekujve ende nuk është e akredituar ku dekan i fakultetit Islam është ai i cili është historian, e prodekane përkthyesja e gjuhës angleze.

Qesharake është edhe fakti se, studenti në fund të vitit të katërt është i barabartë me profesorin në kualifikim, ndërsa tani në FSI ka filluar edhe masteri ku profesori me Bachelor duhet të ju mbaj ligjëratë atyre të cilët janë me master.

Tërnavë Haxhin në Qabë, kurbanat në Hungari

Sikurse çdo vit, Bajrami i kurbanit shkoi. Kjo festë veçohet me kurbanet e cila është e ndërlidhur edhe me kryerjen e haxhit.

Sikurse çdo vit, edhe sivjet Bajrami erdh e shkoi, por nuk erdhi edhe lajmi i shumëpritur (së paku në përrurimin e Bajramit) për ndërtimin e **xhamisë së madhe** në Prishtinë.

Sikurse çdo vit edhe sivjet Bajrami erdhi e shkoi, mirëpo lajmi i shumëpritur i **ligjit për fetë** dhe për Bashkësinë Islame të Kosovës nuk erdhi.

Sikurse çdo vit edhe sivjet nuk erdhi lajmi i futjes së **lëndës fetare** në shkolla publike.

Por për dallim nga vitet tjera, sivjet kreu i BIK-ut haxhin e kreu në Qabë, ndërsa kurbanat në Hungari.

Ndoshta Tërnavë shkoi në haxh për t'i 'fshi' gjynahet dhe të kthehet i 'pastër' prej gabimeve sikurse *atë ditë kur ka lindur dhe t'i përfaqëson dy milion haxhilerë nga e gjithë bota, më falni nga e gjithë Kosova.*

Me rëndësi për të është që vet të i 'fshij' mëkatet, ndërsa pse besimtarët në Kosovë mbushen me mëkate nuk është me rëndësi. Kurbanat që janë blerë dhe therur në Hungari janë nga djersa e besimtarëve të Kosovës.

Besimtarët të cilët kanë paguar nga 120 euro, e që numri i tyre është mbi 7200, do të kishin dashur që të kishin dashur që të ndihmonin edhe blegtorët e Kosovës

dhe të ndihmohej edhe blegtoria e Kosovës. Blegtorët të cilët me mund dhe vështirësi ballafaqohen dhe presin që sofrat e Bajramit të tyre të mbushet dhe të mos mbetet e zbrazët ashtu siç ka mbetur e zbrazët edhe sofrat e besimtarëve (që kanë paguar për kurbanet) në ditën e bajramit sepse kanë kaluar dy javë nga Bajrami por mishi i kurbaneve nuk ka ardhur.

Ndoshta Tërnavat në Haxh është duke u munduar që të ‘fshij’ duart e tij të cilat i ka të përlyera nga mishi i Kurbanave, sepse zemrat e besimtarëve janë mbushur me shpresa të zbrazëta dhe nuk kanë më me çka të mbushen.

Duke e ditur se postin të cilin e mban e ka të UZURPUAR dhe atë që e ka shkruar me dorën e vet mund ta fshij me dorën e vet, por atë që e BËN me dorën e vet nuk mund ta fshij as me dorën e vet dhe as me kryerjen e haxhit.

Iftaret e votave dhe Tërnavë

Ftesa në iftare ka vlerë të madhe, po ashtu vlerë të madhe ka edhe të shtruarit iftare për agjëruesin. Siç dihet, iftare ka edhe para zgjedhjeve por edhe pas zgjedhjeve sepse zgjedhjet janë në mes të Ramazanit. Nga kjo po na rezulton se kemi dy lloje të iftareve:

- Iftare të votave, dhe
- Iftare të Ramazanit.

Iftaret e votave siç duket përfundojnë para gjysmës së Ramazanit, por parashtrohet pyetja se a do të ketë iftare pas votimeve.

Do të kishte qenë mirë që Tërnavë, në iftaret e votave, nga shtruesit e iftareve të kërkonte prej të nominuarve për deputet se si:

- Kaluan 18 vite dhe xhamisë qendrore në Prishtinë ende nuk i është dhënë leja e ndërtimit;
- Kaluan 18 vite dhe lënda fetare nuk është futur në shkolla publike;
- Kaluan 18 vite dhe ligji mbi fetë nuk është aprovuar në Kuvend;
- Kaluan 18 vite dhe kemi pasur një deputete me mbulesë në kuvend por edhe duke qenë deputetja me mbulesë në kuvend prapëseprapë ka pasur tentativa për t'i përjashtuar prej shkollave publike vajzat me mbulesë.

Mirëpo ne po shohim se kur ato iftare publikohen në media dhe publikohen me foto në rrjete sociale, të mbushet mendja se është respekt për agjëruesin, por e

vërteta po del se ato iftare janë për VOTËN dhe jo për të respektuar agjëruesin.

Pasuria e njeriut është e shenjtë dhe e pacenueshme dhe duhet respektuar fitimin e secilit, por nëse e marrim shembull se për 10 milion euro të ndonjë të nominuari për deputet siç është Pacolli, do të kishte obligim 250 000 euro dhënie të zekatit. Por jo, Tërnavë para Pacollit rri kokulur dhe hesht vetëm për një iftar të 10 eurove. E ndoshta vetëm pse e ndërton një xhami në ndonjë vend i jep mirënjohje. Selim Pacolli ka dalë para xhematit të Kaçanikut dhe ka thënë se: Xhaminë në Lagje të re do ta ndërtoj Behxhet Pacolli, ndërsa ajo xhami ka vite që është ndërtuar dhe ai nuk e ka dhënë asnjë cent, përderisa xhemati i Kaçanikut ende mendojnë se Pacolli e ka ndërtuar atë xhami, e Tërnavë ndoshta e ka harruar këtë vetëm për shkak të një iftari të 10 eurove.

Tërnavë nuk e ka guximin që publikisht së paku ta këshilloj se zekati për të (Pacollin) nuk e ka arritur limitin edhe pse ka dhënë një “leckë” të pasurisë, ndërsa në anën tjetër Tërnavë do t’i kërkonte me ngulm nga çdo imam që të tubojnë fitrat dhe zekatin nga xhemati dhe nëse xhemati do ta destinonin dhënien për xhaminë e tyre e jo për BIK-un, atëherë ata kërcënoheshin me përjashtim nga detyra të imamatit, ndërsa kur e dimë se po ndodh që disa xhamive po u ndërpritet rryma e po ka xhami që për shkak të instalimit të vjetër të kabllove po digjet (siç ishte rasti me një xhami në një fshat të Deçanit), e ka xhami të cilat kanë nevojë për gjërat elementare ndërsa tubimin e zekatit dhe fitrave e dërgojnë në BIK, sepse u thuhet se tubimin e fitrave të Ramazanit nuk duhet ta ndalni për xhami por ta dërgojnë vetëm për BIK-un.

E rëndësishme është që vetëm Tërnavë të jetë në post, ndërsa për çështjet tjera besimtarët duhet të kujdesen vet, e ai Tërnavë duhet të kujdeset vetëm për iftaret e votave e jo për realizimin dhe kërkimin e të drejtave të besimtarëve të cilat i përmendëm më herët, sepse edhe vet postin e ka marrë për veten e tij dhe jo për besimtarët.

Tërnavë dhe ‘dekorata’ e tij

Pas luftës së dytë botërore, mulla Idris Gjilani e kishte moton **“Pa një atdhe të lirë, feja nuk mund të mbahet kurrë.”** Ndërsa pas masave të dhunshme të regjimit të Millosheviçit, Naim Tërnavë e nisi me moton **“Atdheu mbi të gjitha** (përpos lëvdatave dhe pozitës)”, ndërsa feja është një gjë e dytë dhe sekondare.

Në kohën e tij, derisa ishte drejtor i medresesë Alaud-dinë, shkollat publike ishin mbyllur, fëmijët shqiptarë të Kosovës mësonin nëpër stalla dhe nëpër shtëpia private, pa tavolina, pa karrige.

Medreseja Alaud-dinë, e cila ishte medrese, shkollë e mesme dhe e përgjithshme, ishte ndërtuar dhe mirëmbahej nga ndihmat vullnetare (fitrave e zekatit) të besimtarëve. Gjatë asaj kohe qindra e qindra konkurronin për t’u regjistruar në medrese, ndërsa pranoheshin dhjetëra, e refuzoheshin me qindra, me arsyetimin se kanë të drejtë të regjistrohen vetëm dy paralele (po kush i ndalonte që ta zgjerohin kapacitetin në katër e pesë, e pse jo në dhjetë paralele, pasi që Kosova me shpalljen e Kushtetutës së Kaçanikut i kishte institucionet e saj paralele?!).

Medreseja organizonte dhjetëra e qindra tubime sepse pas atyre tubimeve ai pasurohej dhe siguronte një jetë luksoze edhe pse popullata jetonte në varfëri të skajshme dhe nxënësit e shkollave tjera nuk kishin as fletore as lapsa e as libra për të mësuar.

Tërnavë sot ka të drejtë të krenohet me ato tubime, por a ka të drejtë të krenohet me refuzimin e qindra

konkurruesve për medrese, të cilët refuzoheshin e mëpastaj detyroheshin që të mësonin në shkolla ku nuk kishte as tavolina as karrige, tjetra, objekti i medresesë kishte kapacitete edhe për shkolla të tjera të mesme, por asnjëherë nuk ju mundësua shkollave tjera të mesme që të mbanin orët e mësimin në objektin e medresesë të cilën e drejtonte ai.

Pat filluar lufta e vitit 1998-1999, me nxitim hoxhallarë dhe haxhilerë, fëmijë të hoxhallarëve dhe haxhilerëve, u renditën në formacione të UÇK-së anë e mbanë Kosovës, dhe derisa isha duke biseduar me ish Komandantin tim (tani dëshmor) Izahir Tronin, ai më tha: - Komandantët i kemi nga fëmijët e hoxhallarëve (duke e përmendur Azem Gurin, djalin e mulla Fejzulla Gurit, i cili ishte kom. batalioni në brigadën 162 Agim Bajrami dhe Eset Malsiun i cili ishte djali i Hafiz Haki Malsiut, i cili ishte kom. batalioni në të njëjtën brigadë), ndërsa në secilin pozicion kemi hoxhallarë, dhe ata, përpos që janë komandantë dhe ushtarë, ata luajnë edhe rolin e eprorit moral ushtarak.

Tërnavë, pas luftës, krenohet me numrin e medresantëve dëshmorë dhe e pa të arsyeshme të investonte të shkruhet libër për dëshmorët medresantë, ndërsa nuk e sheh të arsyeshme të investoj të shkruhet libër për veteranët hoxhallarë e haxhilerë e fëmijë të hoxhallarëve dhe haxhilerëve sepse meritat e dëshmorëve dëshiron t'i uzurpoj për vete, kurse dëshmorët medresantë nuk paraqesin rrezik për pozitën e tij, ndërsa medresantët ushtarë e komandantë paraqesin rrezik për pozitën e tij.

Për Tërnavën, loti i mulla Osman Musliut i cili përloti botën mbarë dhe zgjoi ndjenjat e mbarë botës sepse

simbolizon lotin e nënave, fëmijëve e baballarëve, gjyshërve dhe motrave shqiptare të cilat masakroheshin nga barbarët serbë, nuk përbën asgjë, sepse për të, ai lot është vetëm ujë i cili teret dhe humbet dhe për të nuk ka ndonjë vlerë.

Medresantët e hoxhallarët, fëmijët e hoxhallarëve e haxhilerëve, luftonin anë e kënd Kosovës ndërsa ai iku në Maqedoni, por jo në kampin e Çegranit të Gostivarit, por në vend luksoz.

Pas tij edhe medresanti i tij Bujar Dervishi (ndërsa ka të tjerë të cilët nuk janë pranuar në medrese, e janë ndalur në luftë) mori turrin vrap pas tij, ndërsa prindi i tij Islam Dervishi u ofronte ushqim të shijshëm forcave serbe të cilët masakronin dhe vritnin popullatën shqiptare në bajramin e vitit 1999 e në prill të vitit 1999 e deri më 11 qershor, me qëllim që forcat paramilitare serbe të jenë më të fuqishëm për të masakruar gra, fëmijë e pleq, në Kaçanik.

Pas luftës, nëpër tubime të ndryshme, Tërnavë lavdërohej me dëshmorët medresantë, lavdërohej me veteranë hoxhallarë, ndërsa veteranin hoxhën dhe komandantin e UÇK-së Musli Vërbanin e shkarkon vetëm nëpërmjet medieve dhe emëron Bujar Dervishin, djalin e Islam Dervishit, të cilin e përmenda më parë, ai i cili u ofronte ushqim të shijshëm forcave serbe, të cilët masakronin dhe vrisnin popullatën shqiptare në bajramin e vitit 1999, e në prill të vitit 1999 e deri në qershor, e pas qershorit, me qëllim që forcat paramilitare serbe të jenë më të fuqishëm për të masakruar gra, fëmijë e pleq, në Kaçanik.

Tërnavë, nëpër tubime vazhdimisht shprehet: **“Dëshmorët** (e prej tyre edhe dëshmorët medresantë) **furnizohen te Zoti i tyre.”**, ndërsa në mendjen e tij veteranët medresantë dhe imamët veteranë paraqiten si rrezik për furnizimin e tij në këtë botë.

Në fund, Tërnavës i ka mbetur hatri pse e kanë harruar dhe nuk e kanë dekoruar për vitin jubilar të pavarësisë, ndërsa nuk duhet t’i mbës hatri se pse nuk është i dekoruar, por që në Ditën e Gjykimit do të jetë i mallkuar prej Zotit të Lartmadhëruar sepse ai nuk ka vepruar për Ditën e Gjykimit, por për dekoratë, në kurriz të dëshmorëve dhe në kurriz të veteranëve, në kurriz të atyre të cilët e kishin shpresën tek ai, por shpresa e tyre po del se ka qenë vetëm një zhgënjim.

Muftiu “kukull”

Institucioni mufti nuk është institucion posti, por është institucion shkencor. Në islam, ky institucion, është institucioni më i lartë legjislativ. Si i tillë, ka qenë dhe do të jetë shtyllë përballë sfidave të çdo kohe dhe asnjëherë nuk ka qenë kukull apo lodër e ndokujt edhe pse ndokush bëhet lodër dhe kukull vetëm e vetëm për të ruajtur postin, siç e kemi të ashtuquajturin Mufti Tërnavën në krye të uzurpimit të institucionit të BIK-ut me arsyetimin se vetëm ai është i denjë për këtë post edhe pse ai është më së largu në plotësimin e kushteve të muftisë ashtu siç parashihet në islam.

Më kujtohet njëherë kur Tërnavë është pyetur se *a lejohet që femra të emërohet mufti* e ai është përgjigjet (ka dhënë fetva) me vendosmëri se *nuk lejohet që femra të jetë mufti*. Çfarë ironie, muftiu “kukull” Tërnavë nuk di të bëjë as dallimin e institucionit të fetvasë dhe nuk e di se çka do të thotë mufti, kur dihet se Aishja r.a. ka dhënë fetva dhe Muhamedi a.s. ka thënë: **“Merreni gjysmën e diturisë nga ajo.”**

Kur është pyetur nga një femër se *a lejohet që një burrë të përdorëzohet me një femër*, ai i përgjigjet (ka dhënë fetva) me krenari: - *Qe apo do ta jap dorën sa herë të duash (emisioni Jeta në Kosovë)*. **Fetva e shekullit!!!**

I ashtuquajturi mufti Tërnavë nuk ka hezituari të jap fetva për këto dy çështje, por ka hezituari të përgjigjet për shumë çështje aktuale nga frika se mos bëhet **“bum mediatik”**. I ashtuquajturi mufti Tërnavë nuk frikohet nga

askush siç ai e thotë me gojën plotë te nëpunësit e BIK-ut por i frikohet **“Bumit mediatik”** sepse ja përcjellin fjalët e sipas tij do ta etiketojnë me termin *ekstremizëm* kështu që edhe çdo fetva e tij do të ishte në qendër të vëmendjes!.

Vitet shkojnë e vijnë por edhe nevojat e besimtarëve për fetva rriten e shtohen, por **“muftiu kukull”** nuk mund ta jep një fetva sepse e vërteta është se nuk është kompetent për fetva edhe në bazë të islamit.

Brenda 365 dite i ashtuquajtur mufti Tërnavë me padurim i pret dy ditët e bajramit që së paku në ato dy ditë të fotoqafshet me krerët shtetëror, sepse ai fotografim i përbashkët nuk do të konsiderohet **“bum mediatik”**, por e vërteta është se ajo foto na pasqyron se kemi një **“mufti kukull”** edhe nëse nuk e konsiderojmë **“Bum mediatik”**.

Në fund, ne kemi dëgjuar për *kryetar kukull*, kryetar të ndonjë institucioni shtetëror si post kukulle por nuk kemi dëgjuar **“mufti kukull”**.

Tërnavë, lider i manipulimeve

Në emisionin “Pressing T7”, Naim Tërnavë u paraqit me deklaratën e tij se është “Lider shpirtëror”, mirëpo gjatë emisionit doli e vërteta se ai më shumë është “lider i manipulimeve” sesa “Lider shpirtëror”.

Tërnavë, edhe pse ish profesor i lëndës së *besimit dhe filozofisë islame*, shihet se nuk e di kuptimin e *liderit shpirtëror* sepse lideri shpirtëror nuk mundohet t’i manipuloj faktet ashtu siç mendohej ai gjatë emisionit ashtu siç di vetëm ai.

Ai i cili me dorën e tij e nënshkruan një ndryshim të së ashtuquajturës “Kushtetutë e BIK-ut” se: “Kryetari i BIK-ut nuk ka të drejtë të jetë më shumë se dy mandate”, me qëllim që të mos i jepej mundësia dr. Rexhep Bojës që të rizgjidhej për të tretën herë dhe me qëllim që ai të kandidoj dhe të zgjedhet si kryetar i BIK-ut, e po i njëjti (Tërnavë) para përfundimit të mandatit të dytë e shkarkon kryetarin e kuvendit të BIK-ut (duke u arsyetuar se e ka shkarkuar kuvendi) dhe e ndryshon përsëri të ashtuquajturën kushtetutë, por këtë herë për t’ia lejuar vetes qëndrimin e përjetshëm, pra duke lejuar rizgjedhje të pakufishme. Këtë veprim nuk e bën askush tjetër pos *liderit manipules*, e assesi lideri shpirtëror.

Në të njëjtin emision thotë se, nuk ka pushtet, ndërsa po në të njëjtin emision thotë se, e ka shkarkuar imamin që nga Dubai me anë të telefonit (me telefon nga Dubai më ka shkarkuar edhe mua nga detyra e imamit). Lideri shpirtëror nuk shkarkon imam prej Dubai, ashtu siç

deklaroi Tërnavë, sepse lideri shpirtëror nuk merret me diktate sepse me diktate merret vetëm diktatori.

Për çdo mangësi e cila ndodhë në institucionin të cilin ai e ka uzurpuar, ai thotë se, “nuk ka pasur njohuri”, “janë disa”, “në disa raste”, “nuk ka qenë në dijeninë e tij”. Ndërsa për çdo të mirë thotë se “ka kontribuar”, e dihet mirë se këtë nuk e bën një lider shpirtëror, por vetëm lideri manipulues.

Në fund... Naim Tërnavë më shumë njihet si diktator sesa si lider shpirtëror, sepse shpirti i tij është i mbushur me lakmi për pushtet dhe pasurim material dhe jo për të dhënë ide shpirtërore sepse u pa qartë se ai nuk është i prirë të shpreh ndonjë ide shpirtërore.

Çfarë zgjedhje demokratike organizon Tërnavë në Krye të BIK-ut?!

Para disa vitesh, në emisionin e RTK-së kam pas deklaruar se, “pas lufte deri sa institucionet tjera demokratizohen, BIK-u burokratizohet edhe më shumë”. Edhe pse prej asaj kohe kanë kaluar gjashtë vite, burokratizimi i BIK-ut po bëhet çdo ditë e më i thellë.

Edhe pse zgjedhjet e kaluara nuk kanë sjell asgjë të re, parashtrohet pyetja se çfarë zgjedhje po organizon Tërnavë tani që është në krye të BIK-ut?

Në zgjedhjet e këshillave lokal, ku prej atyre këshillave dërgohen dy delegatë (*Kryetari i Këshillit dhe anëtari i Kuvendit*), **gjinisë femërore u është mohuar e drejta që të votojnë dhe të zgjedhin të deleguarit e tyre**, e që më pastaj të zgjedhurit e tyre të zgjedhin Kryetarin e BIK-ut. Në këtë rast nuk jemi duke folur për t’u kandiduar sepse **ajo e drejtë as që merret parasysh** por i është mohuar edhe e drejta për të votuar. A thua a nuk është kjo diskriminim gjinor?!

(Vërejtje: Nga përafërsisht 800 xhami të Kosovës, në vetëm disa prej tyre ka vendfajle për femra, e a nuk do të thotë se u është mohuar e drejta edhe për të falur namaz e mos të flasim për të pasur të drejtën për të votuar e për t’u zgjedhur?!).

Çfarë zgjedhje demokratike organizohen kur Prishtina me 300 000 deri në 400 000 banorë përfaqësohet barabartë me komuna që kanë prej 10 000 deri 15 000 banorë sepse Këshilli lokal i Prishtinës përfaqësohet me dy delegatë

(anëtarin e kuvendit dhe kryetarin e këshillit lokal) për të votuar kandidatin për Kryetarin e BIK-ut, e po ashtu edhe Këshillat lokal të Komunave prej 10 000 deri 12 000 banorë (e këso janë disa e jo vetëm një) në votim për të zgjedhur kryetarin e BIK-ut përfaqësohen me dy delegatë (njëri anëtar i Kuvendit dhe tjetri Kryetar i këshillit). A nuk është kjo mënyrë ku **pakica vendos për fatin e shumicës?**

Çfarë zgjedhje demokratike organizon Tërnavë në krye të BIK-ut kur Kryetarin e BIK-ut do ta zgjedhin edhe delegatët të cilët janë **zgjedhur në restorante** edhe pse ka vend në xhami dhe objekte tjera publike?!!

Sa ka vendfalje për gjininë femërore në xhamitë e Kosovës?

Në Qaben e bekuar, vendfalja për gjininë femërore është kudo. Në Medinën e ndriçuar është e përcaktuar vendfalja për gjininë femërore. Gjatë historisë islame shohim se vendfalje për gjininë femërore është kushtuar në xhami të ndryshme, madje kemi edhe xhami të emëruara me emra të gjinisë femërore, si f.v., Xhamia e Aishes r.a., Xhamia e Zejnebes, etj.

Tek ne, xhamitë kryesisht ndërtohen ose prej shoqatave humanitare ose me vetkontributin e xhematit.

Për ndërtimin e xhamive, para tubimit të mjeveve financiare nga xhemati, një pjesë e hoxhallarëve pasi deklarojnë për vlerën dhe rëndësinë e kontributit për ndërtimin e xhamive, në të shumtën e rasteve me zë të fuqishëm përmendin se për ndërtimin e “x” xhamisë, ***gratë i kanë dhënë edhe bylyzykët e arit, e edhe qaforet e arit, dhe kanë mbetur pa ari sepse të tërin e kanë dhënë për ndërtimin e asaj xhamie, andaj kontribuoni edhe ju o xhematë i nderuar*** – thërrasin ata.

Po, është e vërtetë, nënat tona e kanë dashur dhe e duan fenë islame. Kanë kontribuar dhe kontribuojnë për fenë islame. Kanë ndihmuar dhe ndihmojnë për fenë islame, por ne, a kemi menduar që atyre t’u jepet mundësia që ta falin namazin në xhamitë e Allahut. Ne ua kemi mohuar të drejtën elementare të tyre, ua kemi mohuar faljen nëpër xhami duke mos ua paraparë atyre vendfaljen. Nga 800 xhami sa ekzistojnë në Kosovë, mund

të thuash se vetëm në disa prej tyre apo më mirë me thënë nga 800 xhami vetëm sa numri i gishtave të duarve ka vendfalje për gjininë femërore, pra me shumë gjasë vetëm një përqind e xhamive ka vendfalje për gjininë femërore. A nuk ka thënë Muhamedi a.s.: **“Mos e ndaloni gjininë femërore (robëreshat e Allahut) që të falen në xhamitë e Allahut.”**

Imamët “jetim” të Kosovës

Kosova numëron përafërsisht 800 xhami, që do të thotë se nëse secila xhami e ka imamin, atëherë rezulton se janë 800 imamë (përpos imamëve tjerë).

Nga këto xhami shumë prej imamëve janë imam “jetim”, në xhami “jetime”.

Kujdestari i këtij imami “jetim” është njerku (BIK-u) i cili kërkon prej tij (imamit “jetim”) vetëm të tuboj fitrat dhe zekatin, vetëm të sjell kurbana, haxhilerë dhe nga fitimet e tyre të ulet në “kancelari”. Nga fitimet e nxjerra të mos bëhet shpërndarja e barabartë e fitimit, por fitimi të ndalet në “kancelari” dhe nga aty të del në TV dhe të thotë se **“duhet të jeni solidar për muajin ramazan të ndajmë nga ajo që kemi për ata të cilët nuk kanë”**.

Përderisa një shoqatë e jetimëve është në gjendje të ndërtoj dhjetëra apo qindra shtëpi për nevojtarët, njerku (BIK-u) i imamëve “jetim” nuk është në gjendje të ndërtoj shtëpi pranë xhamive “jetime” në mënyrë që ai imam të jetë i rregullt në namazet ditore të asaj xhamie.

Në ditën e xhuma para mesit të ditës gëzohet xhamia “jetime” sepse do të jetë e mbushur me xhemat për faljen e namazit të xhumasë, mirëpo ky gëzim nuk zgjat shumë sepse pas dite fillon të pikëllohet duke e ditur se deri në ditën e xhuma të javës tjetër nuk do të vjen imami “jetim”, nuk do të vizitohet nga xhemati, nuk do të falen namazet ditore në të, por vetëm namazi javor (namazi i xhumasë). Ajo do t’i qëndroj stuhive të borës dhe shiut, por nuk do t’i

përballoj stuhive të anashkalimit nga imami “jetim” dhe nga kujdestari i atij imami “jetim” (BIK-u).

Si e konsideron kujdestari (BIK-u) këtë imam “jetim”? A e konsideron këtë imam “jetim” si pjesë të familjes, apo...? A nuk ka thënë Muhamedi a.s. **“Ushqimi i dy vetave mjafton për tre dhe ushqimi i tre vetave mjafton për katër”**. A nuk ka të bëjë ky hadith për shpërndarjen e fitimit të barabartë në mes të punëtorëve të një institucioni (në këtë rast të BIK-ut) pasi që të gjithë imamët janë një familje, brenda një ombrelle?!!

Xhamitë dhe objektet përcjellëse të tyre

Xhamitë në rend të parë kanë qenë vendfalje (mesxhid), e aty pastaj janë zhvilluar aktivitetet e kuvendimit shoqëror (kuvendimit komunal), pastaj ka shërbyer si institucion arsimor, pastaj institucion legjislativ, e edhe institucion ushtarak.

Me kalimin e kohës xhamisë i është marrë institucioni ushtarak.

Më vonë i është marrë edhe ai gjyqësor.

Pastaj edhe institucioni i kuvendimit shoqëror (kuvendimit komunal) dhe në fund edhe ai arsimor, dhe kështu ka mbetur vetëm funksioni i faljes së namazit.

Duhet ditur se nga mektebet e xhamive kanë rrjedhur universitetet islame.

Pas zhveshjes së xhamisë nga aktivitetet e sipërpërmendura:

- objekti i institucionit arsimor është zëvendësuar me objekt të gasulhanes, dhe
- objekti i kuvendimit shoqëror (kuvendimi komunal) është zëvendësuar me objektin e ngushëllimeve në rast vdekjeje (të pames).

Nuk jam duke folur për mos ndërtim të objektit të gasulhanes dhe të *pames* sepse edhe këto janë objekte islame, por duhet që këto objekte përcjellëse të xhamisë të ndërtohen pas (ose paralel) ndërtimit të mësonjëtores (mektebit) së xhamisë dhe pajisjen me elementet e

nevojshme, si f.v., tavolinat, karriget, kompjuterë e projektorë, etj. Ne shohim se si në shumë xhami nxënësit mësojnë të kërrusur, pa tavolina e pa karrige, pra pa ambient të përshtatshëm për mësim.

Siç e përmenda më lartë, duhet filluar nga ndërtimi i mektebit afër xhamisë e pastaj ndërtimi i gasulhanes dhe objektit për ngushëllime (për të pame) sepse nëse nuk ka mësuar në mekteb ku leximi ia mëson njeriut ta njoh Krijuesin dhe mënyrën e jetesës sipas programit të Tij, atëherë çfarë dobie do të kishte ai nëse i pastrohet kufoma në gasulhane dhe organizohet e pame për të në objekt përcjellës të xhamisë.

Nuk ndërtohet stacioni i fundit para se të ndërtohet stacioni i nisjes (nuk ndërtohet kulmi para themelit të objektit), e stacioni i nisjes së jetës është mektebi, ndërsa stacioni i fundit është vdekja, ku i vdekuri duhet të pastrohet dhe pastaj të vazhdohet me pritjen për ngushëllime (për të pame) e me shpresë se Zoti i Lartmadhëruar t'i shpërblej të vdekurit tanë me xhenet pas edukimit të tyre në këtë botë.

Demagogjia e Naim Tërnavës me rastin e urimit të ramazanit

Edhe pse Ramazani është shkencë në vete, si e tillë duhet të studiohet dhe të veprohet dhe që prej tij të përfitohet në të gjitha aspektet. Në urimin Ramazanit nga ana e Tërnavës, më datën 15 maj 2018 në mes tjerash thotë, citoj: “Agjërimi është shkollë humanizmi. Vlerat solidare agjërimin e bëjnë një mundësi më shumë për të zbutur varfërinë”. (*Urimi i Muajit të Ramazanit, Prishtinë, 15 maj 2018*). Po për çfarë shkolle na tregon Tërnavë kur këmbët e tij nuk munden ta mbajnë mbipeshën dhe barkun e tij plotë të stërmbushur ndërsa këmbët e shumë të varfërve nuk e mbajnë trupin e tyre për shkak të dobësisë së tyre dhe sepse e kanë të zbrazur barkun e tyre. Pastaj në vazhdim në mes tjerash thotë, citoj: “për t’ia kujtuar të pasurit shijen e hidhur të urisë që të varfrit e kanë përditshmëri.” (*Urimi i Muajit të Ramazanit, Prishtinë, 15 maj 2018*). Po çka t’i kujtohet shija e hidhur e urisë te i pasuri si Tërnavë ku vetëm përgatitjet për shujtën e iftareve gjatë Ramazanit për të dhe që ai nuk do të mund t’i konsumoj dhe që pastaj hidhet, e që prej asaj pjese të hedhur ndoshta do të ushqeheshin me dhjetëra të varfër. Pra, a nuk është kjo demagogji e llojit të vetë Tërnavës!.

Ndërtimi i “Xhamisë së madhe” në Prishtinë dhe “vakëfet”

Pas luftës së dytë botërore, në Shqipëri, për t’u ndaluar feja, u morën vakëfet, u shkatërruan xhamitë, ndërsa në Kosovë, u morën vakëfet, ndërsa nuk u shkatërruan xhamitë. Në Shqipëri, qëllimi ishte që feja të ndalohej menjëherë, ndërsa në Kosovë, qëllimi ishte që feja të ndalohej apo zhdukej në mënyrë graduale, për këtë arsye edhe u morën vakëfet nga ana e shtetit. Mirëpo liderët fetarë dhe popullata edhe me ato vështirësi ekonomike që i kishin, ndihmuan që feja të ruhej edhe pa vakëfe. Me rrëzimin e shtetit komunist filloi edhe shtimi i vakëfeve në Kosovë.

Pa marrë parasysh se a do të ndërtohet “Xhamia e madhe” në Prishtinë, me apo pa lokale, prapë se prapë qytetarët do të lënë vakëfe, sepse vakëfi ka karakter fetar, me qëllim që të ndihmojë dhe zhvillojë fenë. Vakëfi është “afrim tek Allahu”, fitim i kënaqësisë së Allahut dhe shpëtim në botën tjetër dhe është ndër veprat nga të cilat njeriu fiton shpërblime edhe pas vdekjes.

Vakëfi i parë dhe më i rëndësishmi është Mesxhidi Harami, pra Qabeja, së cilës themelet ia ka ngritur dhe e ka ndërtuar Ibrahim i a.s. me të birin e tij Ismailin a.s., pra vakëf është edhe xhamia, por vakëf janë edhe lokalet, spitalet, urat, rrugët, e të ngjashme, etj.

Qëllimi i vakëfit është që të ndihmojë zhvillimin e jetës fetare dhe shoqërore.

Feja zhvillohet duke lënë vakëf: xhami, mesxhide, shkolla, biblioteka, etj. Shoqëria zhvillohet duke lënë vakëf: spitale, ura, rrugë, e të ngjashme.

Vakëfi nuk lejohet as të pronësohet, as të harxhohet, as të dhurohet, e as të trashëgohet.

Kushti i vënë në vakëf është njësoj si Ligji i Zotit – Ligjvënës. Kjo nënkupton se ashtu siç nuk lejohet të ndryshohet një ajet Kur'anor, ashtu nuk lejohet të ndryshohet ndonjë kusht i vakëfit, e po ashtu nuk lejohet edhe ndryshimi i destinimit të të hyrave të atij vakëfi.

Dhjetëra e dhjetëra xhami janë ndërtuar, të cilat kanë kushtuar me qindra mijëra euro dhe sot në ato xhami falet vetëm namazi i xhumasë (e ndoshta as namazi i xhumasë) sepse nuk ka mjete për t'u paguar imamët, ndërsa ka mjete për luksin e krerëve të BIK-ut, të cilët shpenzojnë mjete si ua do qejfi.

Populli ynë, i cili është dashamirës i fesë, ka ndërtuar vëkëfe xhami gjithandej Kosovës, të cilat kanë kushtuar me qindra mijëra euro, por ato xhami ose nuk kanë imam ose kanë imam vetëm për namaze të xhumasë, sepse krerët e BIK-ut, vakëfet simbolike të cilat janë shtuar i ka përvetësuar për vete, e jo për zhvillimin e fesë islame. Nuk dua të them se veprimi i atyre të cilët pengojnë lokalet vakëf në Xhaminë e madhe është veprim i mirë, por them

se lokalet vakëf të cilat i kanë keqpërdorur krerët e BIK-ut janë veprime të ndaluara dhe janë të njëjta me veprimet e atyre të cilët pengojnë ndërtimin e lokaleve vakëf. Ja një shembull për ilustrim, nënkryetari i BIK-ut, në vendin ku ka qenë medreseja e Ferizajit në qendër të Ferizajit nuk ka ndërtuar medrese apo xhami, por është ndërtuar ndërtesë banimi, dhe banesat i kanë blerë Krerët e BIK-ut, përkatësisht ish nënkryetari i Naim Tërnavës, tash dekan i FSI-së Fahrush Rexhepi. Pra, ky ka blerë vakëfin e KBI-së së Ferizajit dhe e ka shitur atë, e ky objekt ka qenë në vendin e ish medresesë së Ferizajit, që do të thotë se e ka stërshitur vakëfin dhe ka abuzuar me të.

Përmbajtja:

HYRJE.....	4
NAIM TËRNAVA U KUJDES VETËM PËR TA RUAJTUR POSTIN E TIJ	8
A PUNON BIK-U “NË TË ZEZË”	9
LIGJËRIMI PËR VETEN DHE POZITËN.....	11
BIK-U DJE DHE SOT	13
TËRNAVA HAXHIN NË QABE, KURBANAT NË HUNGARI	16
IFTARET E VOTAVE DHE TËRNAVA.....	18
TËRNAVA DHE ‘DEKORATA’ E TIJ	21
MUFTIU “KUKULL”	25
TËRNAVA, LIDER I MANIPULIMEVE.....	27
ÇFARË ZGJEDHJE DEMOKRATIKE ORGANIZON TËRNAVA NË KRYE TË BIK-UT?!.....	29
SA KA VENDFALJE PËR GJININË FEMËRORE NË XHAMITË E KOSOVËS?	31
IMAMËT “JETIM” TË KOSOVËS	33
XHAMITË DHE OBJEKTET PËRCJELLËSE TË TYRE.....	35
DEMAGOGJIA E NAIM TËRNAVËS ME RASTIN E URIMIT TË RAMAZANIT.....	37
NDËRTIMI I “XHAMISË SË MADHE” NË PRISHTINË DHE “VAKËFET”	38